



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 3 mars 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA në këtë mbledhje u njoh:

- Me angazhimin e deritanishëm të Autoritetit të Mediave Audiovizive në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor.
- Me informacionin mbi shërbimet programore që mbarten në rrjetet numerike private kombëtare dhe ra dakord që në mbledhjet vijuese të propozojë ndryshime ligjore për zgjidhjen e problematikave të konstatuara.

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “SCAN” sh.a. duke vendosur ndryshimin e emërimit të subjektit audio nga “Radio Scan” në “Radio Alpet”. **(Vendimi nr. 35, datë 03.03.2021)**
2. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Adriatik Bajrami, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Delvina”, në “*Bashkinë Finiq*”. **(Vendimi nr. 36, datë 03.03.2021)**
3. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “ACENET” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “ACENET”, me zonë ofrimi shërbimi në “*Bashkinë Lushnje*”. **(Vendimi nr. 37, datë 03.03.2021)**
4. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Mariuxho” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Bulqiza”, për zgjerimin e zonës së shërbimit në njësitë administrative Shupenzë, Ostren dhe Gjoricë”. **(Vendimi nr. 38, datë 03.03.2021)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 03.03.2021